


BASHKIA MALIQ



RAPORTI I PERFORMANCËS 2022



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2022 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2022 të bashkisë Maliq.

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Maliq me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Përmbajtja

Fjalor Shpjegues.....	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	4
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	5
Vështrim mbi Zbatimin e Buxhetit për Vitin 2022	6
Burimet e Financimit	7
Shpenzimet Buxhetore.....	10
Treguesit Financiarë	12
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi.....	13
Shërbimet e Policisë Vendore.....	16
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	17
Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve. 19	
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	20
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	22
Rrjeti rrugor rural.....	24
Menaxhimi i mbetjeve.....	26
Planifikimi Urban Vendor	28
Shërbimet Publike Vendore.....	30
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime.....	32
Shërbimet e Kujdesit Parësor.....	34
Sport dhe argëtim	35
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	36
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	38
Arsimi i mesëm i përgjithshëm.....	40
Përkujdesi Social	42
Strehimi Social	46

Fjalor Shpjegues

Indikator / tregues performance

Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga qeveria) si për shembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj. Treguesit vlerësojnë suksesin ose përparimin e një procesi, produkti ose aktiviteti specifik të bashkisë. Ata gjurmojnë arritjet kryesore të performances së bashkisë.

Produkt i bashkisë

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e shumë shërbimeve publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Shembujt e produkteve bashkiake përfshijnë atë çfare realisht prek qytetari. Produktet e bashkisë zakonisht financohen përmes taksave dhe burimeve të tjera të të ardhurave, të tilla si tarifatat e shërbimeve, grantet dhe transfertat e qeverisë dhe donatorëve si edhe huamarrja. Ofrimi i produkteve bashkiake është një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes vendore, pasi ndihmon për të siguruar që banorët të kenë akses në shërbimet thelbësore që janë të nevojshme për shëndetin, sigurinë dhe cilësinë e jetës së tyre.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak.

Tarifatat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia.

Transfertat e kushtëzuara, të pakushtëzuara dhe specifike

Janë fonde që përkatësisht Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë (kushtëzuara) ose për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi (pakushtëzuara). Transfertat specifike janë fonde që qeveria i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë me ligj të veçantë.

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë

Bashkia Maliq e pozicionuar në Jug-lindje të vendit përbëhet nga 7 Njësi Administrative: Maliq qendër, Pojan, Libonik, Vreshtas, Pirg, Gorë dhe Moglicë me sipërfaqe prej 698 km². Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Maliqit. Popullsia e bashkisë numëron mbi 62 mijë banorë sipas të dhënave të Regjistrit Civil.

Bashkia drejtohet në mandatin e tretë të tij nga Kryetari i sapo zgjedhur **Z. Gëzim Topciu**.

Viti 2022 shënoi një vit të rimëkëmbjes pas dy viteve të vështira pandemike, duke risjellë rimëkëmbje të biznesit.

Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

E DHËNA	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	62674	62328		62328
Popullsia në qytet	7713	7713	7683	7713
Popullsia në njësitë administrative	54961	54615	5433	54615
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	698	698	698	698
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	40	40	40	40
Sipërfaqja e njësive administrative në total	658	658	658	658
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	22000	22000	25847	22000
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	11300	11300	6649	11300
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	24063	24063	24063	24062,5
Numri total i njësive administrative të bashkisë	7	7	7	7
Numri i fshatrave	82	82	82	82
Punonjës të bashkisë në total	564	577	585	574
Numri total i punonjësve femra të bashkisë			255	
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë			330	
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	147	152	98	153
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë			61	

Vështrim mbi Zbatimin e Buxhetit për Vitin 2022

Gjatë vitit 2022 buxheti i bashkisë është zbatuar në mënyrë të ekuilibruar dhe është realizuar në masën 94%, duke përdorur 100% të të ardhurave të bashkisë.

Përkujdesi social, administrimi i bashkisë, shërbimet publike vendore dhe furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime janë shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022.


Bashkia ka përmirësuar shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh përmes të cilit janë financuar shërbime të tilla si: Rrugët rurale dhe rrugë të brendshme në qytet, Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime, Shërbime publike vendore, etj. Bashkia ka rritur vlerën e investimeve për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Projektet e investimeve në vitin 2022 janë realizuar në masën 79% krahasuar me planin e këtij viti.

Bashkia ka synuar të përmirësojë eficiencën financiare dhe mirë administrimin e parave duke ofruar më shumë shërbime dhe cilësi më të lartë të tyre për komunitetin.

Burimet e Financimit

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
596 139	645 363	698 307	854 239	82%

Kategoria	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhurat nga taksat lokale	31 585	45 398	49 826	109 468	46%
	Të ardhurat nga taksat e ndara	27 546	26 078	29 100	20 800	140%
	Të ardhurat nga tarifatat	39 528	55 538	53 923	157 418	34%
	Të ardhura të tjera	10 928	9 936	11 219	12 314	91%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e pakushtëzuar	293 303	299 169	309 640	309 640	100%
	Transferta e kushtëzuar					
	Për funksionet e deleguara					
	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)					
	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	151 732	167 554	165 898	165 898	100%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion					
	Trashëgimi me destinacion	41 517	41 690	78 701	78 701	100%
TOTALI		596 139	645 363	698 307	854 239	82%



Dy fjalë mbi të ardhurat:

Të ardhurat e bashkisë përbëhen nga:

Të ardhurat nga burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore realizuar në masën 46% dhe taksat e ndara me realizim në masën 140%, të ardhurat nga tarifat vendore të cilat janë realizuar në masën 34% dhe të ardhura të tjera të bashkisë realizuar në masën 82%, përfshirë edhe trashëgiminë nga Fakt 2021. Të ardhurat e veta kanë zënë mesatarisht 21% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.

Të ardhurat nga transfertat e qeverisë qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar. Të ardhurat nga buxheti qendror kanë zënë mesatarisht 68% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.


Trashëgimi nga vitet e shkuara, ku përfshihen trashëgimi pa destinacion dhe trashëgimi me destinacion. Duke marrë parasysh nga Fakt 2021, trashëgimia ka zënë mesatarisht 11% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë. Përgjatë vitit 2022 financat e bashkisë karakterizuar nga:

- Rritja e mbështetjes së shërbimeve sociale në tërësi.

- Ruajtja e peshës që zënë të ardhurat e veta të bashkisë si edhe ato nga taksat dhe tarifat vendore në totalin e burimeve të financimit.
- Dyfishimi i peshës së investimeve dhe rënia peshës së shpenzimeve korente (për mirëmbajtje, paga; etj) në tërësinë e buxhetit të bashkisë.
- Rritja e peshës së të ardhurave të veta të bashkisë në tërësinë e burimeve të financimit të buxhetit të saj.
- Ekzekutimi i buxhetit mbetet në të njëjtat nivele duke u treguar të kujdesshëm për të mos krijuar borxhe të reja kundrejt të tretëve.

TRENDI I TË ARDHURAVE NË VITE




Shpenzimet Buxhetore

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
1 023 879	1 162 787	1 340 304	1 430 957	94%

Shpenzimet buxhetore sipas programeve

Shërbimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Përkujdesi Social	445 193	515 994	526 319	526 319	100%
Rrjeti rrugor rural	57 480	63 463	68 734	102 419	67%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	93 341	86 262	97 705	101 479	96%
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	28 323	41 752	120 875	120 876	100%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	159 302	179 113	182 199	210 370	87%
Shërbimet Publike Vendore	132 257	148 175	160 709	180 029	89%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	40 547	51 529	86 716	87 152	99%
Menaxhimi i mbetjeve	-	-	-	-	
Planifikimi Urban Vendor	-	-	-	-	
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	10 152	10 807	12 902	14 570	89%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	12 805	17 288	19 571	19 963	98%
Sport dhe argëtim	-	-	-	-	
Strehimi Social	9 158	12 437	25 461	25 461	100%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	7 039	7 910	9 103	10 921	83%
Shërbimet e Policisë Vendore	7 335	6 078	7 723	8 360	92%
Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve	7 310	7 504	7 354	8 101	91%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	13 637	14 475	14 933	14 937	100%

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK NË VITE



Dy fjalë mbi shpenzimet:

Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 kanë qenë 1.34 miliardë lekë dhe janë realizuar në masën 94% krahasuar me shpenzimet e planifikuara për këtë vit. Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 shënuan rritje kundrejt vitit 2021 me rreth 15%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

Shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022 janë:

- * *Përkujdesi Social*
- * *Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi*
- * *Rrjeti Rrugor Rural*
- * *Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin*
- * *Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime*

Treguesit Financiarë

Treguesi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	171,8%	180,2%	191,9%	167,5%	▲
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifafat vendore ndaj totalit të të ardhurave	11,9%	15,6%	14,9%	31,2%	▼
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	18,4%	21,2%	20,6%	35,1%	▼
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	9,8%	11,6%	20,0%	23,8%	▲
Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale	90,2%	88,4%	40,8%	39,4%	▼
Norma e shpenzimeve për paga dhe sigurime ndaj shpenzimeve totale	31,5%	29,8%	26,7%	26,0%	▼
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	▬
Norma e shpenzimeve në politikafat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	44,4%	45,4%	41,2%	38,6%	▼

Dy fjalë mbi situatën financiare të bashkisë:

Treguesit kyç financiarë japin një pamje të menaxhimit financiar të fondeve publike të bashkisë. Përtej tendencave vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkisë, këto tregues synojnë të japin informacion mbi qëndrueshmërinë financiare dhe performancën reale të bashkisë.

Gjatë vitit 2022, bashkia ka shpenzuar 100% të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha burimet. Pjesa më e madhe e shpenzimeve buxhetore janë përdorur për shpenzime operative në masën 80% dhe 20% për investime.

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë



Menaxhimi financiar



Gjendja civile

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	101 737	113 227	113 149	114 120	99%
Të tjera korrente	53 161	53 227	51 949	43 108	121%
Kapitale	4 404	12 659	17 101	53 142	32%
Total	159 302	179 113	182 199	210 370	87%

Projektet Kryesore të Investimeve

Emërtimi i Projektit	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Rikonstruksion Qendra Kom.Kulturore Maliq faza e I-rë			0	10000
Rikonstruksion objekte ndertimore			0	14000
Bashkefinansim projektesh			1182	1000
Kompjutera			493	500
Mbikqyrje+Kolaudim	1054	2264	2561	4680
Rikonstruksion pallati blloku 1 Maliq	906		0	
B/F permiresin I banesave	2444		0	
Sistemim lulishte Kisha Maliq		162	0	
Blerje pajisje zyre		66	0	
Rikonstruksion pallate			0	4053
Hartim projekte			447	2467
Suvatim I jashtem magazina	0	0	1304	0

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Raporti në % mes punonjësve të trajnuar dhe punonjësve total	2	10		3	
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Numri i punonjësve të administratës që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve të administratës (raporti në %)	19	11		29	

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve të bashkisë (raporti në %)	5	3		8	
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Numri i konsultimeve me publikun të realizuara në vit kundrejt numrit të konsultimeve me publikun që parashikon ligji (në %)	0	167		100	Rritës
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Numrit total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët kundrejt numrit total të mbledhjeve bashkiake (në %)	100	90		100	Rritës
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Raporti në % i numrit të vendimeve bashkiake që janë marrë pas konsultimit me publikun kundrejt numrit total të vendimeve bashkiake	4	5	10	10	Rritës
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Instrumenta për transparencën të publikuar, ndryshimi vjetor në numër	0	0	0	0	Stabël
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Raporti mesatar i ditëve të trajnimit ndaj personave të trajnuar (ditë trajnimi/person)	2	4	10	13	Rritës
Gjendja civile	Koha mesatare e pritjes për të marrë 1 certifikatë (ndryshimi në minuta kundrejt vitit të kaluar)	0	0	-5	0	Zbritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Totali i të ardhurave (Të vetat QQ Donacionet etj mijë lekë)	mije lekë	596139	645363	872477	872477
Numri total i vendimeve bashkiake	numër	106	106		70
Vendime bashkiake të marra pas konsultimit me komunitetin	numër	4	5		7
Punonjës të bashkisë në total	numër	564	577	585	574
Koha mesatare për marrjen e dokumentave nga momenti i aplikimit në gjendjen civile	në minuta	5	5		5
Shpenzime të Gjendjes Civile (mijë lekë)	mije lekë	6577	5377		4710
Numri total i punonjësve që kanë lëvizur nga administrata brenda vitit	numër	28	16	8	45
Numri total i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur nga puna brenda vitit	numër	28	16	58	45
Numri total i punonjësve në njësitë shpenzuese	numër	417	425	-	421
Totali i të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë (mijë lekë)	mije lekë	110	137	144	300
Të ardhurat e arkëtuara nga prodhimi i dokumentave në lekë	mije lekë	2417			2955
Numri i dokumentave të prodhuar/lëshuar + regjistruar nga gjendja civile	numër	21636	33345		25759
Ditë trajnimi në total	numër	20	207	46	200
Shpenzime për investime programi administratës	mije lekë	226	134	17	19
Shpenzime kapitale (investime) të programit të administratës	mije lekë			17101	19139
Punonjës të trajnuar	numër	11	59	44	16
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	numër	147	152	98	153
Total i shpenzimeve buxhetore (mijë lekë)	mije lekë	1023	1163	13403	1404
Numri total i mbledhjeve KB të hapura për qytetarët	numër	14	18	18	12
Numri total i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	numër	14	20	18	12

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Shpenzime korente totale të bashkisë	mije lekë	600	682	1073	1029
Numri i konsultimeve publike të kryera	numër	0	10		10
Numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj	numër	7	6		10
Toral i detyrimeve të prapambetura në mijë lekë	mije lekë	14121			
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit Meshkuj	numër			42	
Shpenzime korente programi administratës	mije lekë			16367	
Numri total i personave të trajnuar Meshkuj	numër			35	
Numri total i detyrimeve gjyqesore	numër			1	
Detyrimeve Gjyqësore të përmbushura	numër			1	
Numri i subjekteve tregtare të inspektuara nga njësia e të ardhurave / taksave vendore	numër			454	
Punonjës të trajnuar femra	numër			8	
Numri i masave disiplinore të marra nga punonjësit e bashkisë	numër			7	
Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak	numër			122	
Punonjës që janë ulur në detyrë në administratë brenda vitit	numër			-	
Numri total i punonjësve femra që kanë lëvizur nga administrata brenda vitit	numër			3	
Numri total i punonjësve femra që kanë lëvizur nga puna brenda vitit	numër			16	
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën	numër			61	
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	numër			255	
Detyrime financiare që janë nën afatin 60 ditë kalendarike (mijë lekë)	mije lekë			-	
Numri i masave disiplinore të marra nga punonjëset femra të bashkisë	numër			4	
Punonjëse femra që janë ulur në detyrë në administratë brenda vitit	numër			-	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia gjatë vitit 2022 ka rritur kapacitet e burimeve njerëzore duke rritur trajnimet për punonjësit e saj. Është ulur koha e shërbimit të popullatës nga ana e gjendjes civile duke u shërbyer me shpejt dhe më mirë. Bashkia dhe këshilli bashkiak kanë qenë më transparent duke bërë konsultim me publikun për buxhetin dhe paketën fiskale dhe realizuar 100% mbledhje të hapura për publikun.

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 87% të planit 2022. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2022 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2022 tregon se:

- ✱ Është përmirësuar monitorimi i proceseve të brendshme në punë kjo ka cuar në gjetjen e më shumë parregullsive e për rrjedhojë më shumë masa disiplinore dhënë punonjës të bashkisë;
- ✱ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratë. Është dyfishuar numri mesatar i ditëve të trajnimit për një person të trajnuar;
- ✱ Është ulur numri i personave që kanë lëvizur nga puna duke rritur qëndrueshmërinë e administratës.

Shërbimet e Policisë Vendore

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Siguria në komunitet



Parandalimi i kundravajtjeve administrative

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	6 637	6 008	7 165	7 621	94%
Të tjera korrente	698	70	558	739	76%
Kapitale	-	-	-	-	-
Total	7 335	6 078	7 723	8 360	92%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2022
Parandalimi i kundravajtjeve administrative	Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra (në %)	96
Siguria në komunitet	Raporti në % i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura kundrejt numrit të tyre në total të ardhur në policinë bashkiake	45
Shërbimet e Policisë Vendore	Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara (mijë Lekë të shpenzuara për 1 rast të menaxhuar)	227

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Shpenzime buxhetore për shërbimet e Policisë Bashkiake (mijë lekë)	lekë	7335	6078	7949	8360
Numri i punonjësve të Policisë Bashkiake të Trajnuar	numër	10	10	2	10
Punonjës me statusin oficer të Policisë Bashkiake	numër	1	1	1	1

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Numri i akteve administrative të ekzekutuara nga Policia Bashkiake	numër	0	0	77	0
Raste konfliktesh/mosmarreveshjes te zgjidhura nga policia bashkiake	numër			35	
Numri i rasteve të konflikteve /mosmarreveshjeve të raportuara dhe regjistruara në Policinë Bashkiake	numër			77	
Numri i grupeve te patrullimit te Policise vendore	numër			6	
Gjoha të vendosura nga Policia Bashkiake	numër			28	
Numri i mbështetjeve të IMT	numër			4	
Sigurimi i mbarëvajtjes së festave vendore dhe kombëtare	numër			18	
Kamera të vendosura në pikat strategjike të qytetit	numër			0	
Numri i akteve administrative të nxjerra nga organet e QV	numër			80	
Numri total i punonjësve femra të Policisë Bashkiake	numër			2	
Punonjëse femra me statusin oficer të Policisë Bashkiake	numër			0	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Policia bashkia ka rritur prezencën dhe ndërhyrjen e saj efektive në ndihmë të komunitetit duke zgjidhur një numër më të madh konfliktesh, mbështetje të administratës për prishjen e ndërtimeve pa leje, ekzekutimin e akteve të nxjerra nga bashkia dhe institucione të tjera publike. Janë rritur masat e mara kundrejt shkeljeve të ndryshme, duke shënuar kështu 77 raste të konflikteve në total brenda vitit të cilat 35 janë zgjidhur nga policia bashkiake në kohë reale ndërsa të tjerat me marveshje midis palëve të përfshira në konflikt. Policia bashkiake përbëhet nga 12 efektivë , dy prej të cilëve janë të trajnuar , 1 ka statusin Officer i Policisë Bashkiake, 2 janë efektive gjinia femër.

Performanca e policisë bashkiake për vitin 2022 mund të konsiderohet e shkëlqyer pasi ajo ka ekzekutuar pothuajse të gjitha aktet e nxjerra (në nivelin 96%).

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Shërbimi zjarrfikës



Emergjencat civile



Mbrojtja civile

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	9 993	10 568	10 650	10 921	98%
Të tjera korrente	2 692	3 283	3 895	9 042	43%
Kapitale	120	3 437	5 026	-	
Total	12 805	17 288	19 571	19 963	98%

TREGUESIT E PERFORMANËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit (ndryshimi vjetor në numër)	7	39		-21	Rritës
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Dalja nga stacioni (ndryshimi në sekonda kundrejt vitit të kaluar)	0	0		0	Rritës
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Numri i stacioneve MZSH	1	1	1	1	
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Total shpenzime për SHMZ kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë	156	143		200	Rritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Sipërfaqja totale e bashkisë (Km2)	km2	698	698	698	698
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	numër	62674	62328		62328
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatare ditën dhe natën)	në sekonda	50	50		50
Total shpenzime për MZSH (mijë lekë)	mijë lekë	12805	17288		19963
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit	numër	82	121		100
Numri i stacioneve MZSH	numër	1	1	1	1

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia ka krijuar dhe bërë funksionale qendrën e zjarrfikëses të cilën e mori si funksion nga QQ në janar 2016. Qendra ka 3 mjete nga të cilat një është e re dhe kapacitet prej 14 personash të trajnuar rrit në mënyrë të ndjeshme infrastrukturën për shpëtimin e civilëve dhe pasurisë së komunitetit. Punonjësit e zjarrëfikses janë trajnuar kjo ka bërë që reagimi dhe koha e daljes nga stacioni në një kohë prej 40 sekondash ndaj thirrjeve të popullatës të jetë i shpejtë dhe tju gjendet në kohë nevojtarëve duke minimizuar pasojat në pronë dhe jetë. Efikasiteti dhe shpejtësia në dalje nga qendra dhe mbëritje në vendngjarje bëhet në kohë reale duke minimizuar në këtë mënyrë dëmet në pronë dhe jetë. Me një realizim prej 98% në një numër total prej 121 ngjarjesh të menaxhuara për shuarjen e zjareve dhe shpëtimit tregon për një punë shumë të mirë të kryer nga stafi i MZSH Maliq.

Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Skemat vendore të granteve për bujqësinë



Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore



Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	7 310	7 489	7 081	7 869	90%
Të tjera korrente	-	15	273	232	118%
Kapitale	-	-	-	-	
Total	7 310	7 504	7 354	8 101	91%

TREGUESIT E PERFORMANËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore	Sipërfaqja e tokës bujqësore në vitin korrent në ha minus sipërfaqen e tokës bujqësore në vitin e kaluar (në ha).	1	0	0	-1	Stabël
Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore	Certifikata të pronësisë të aplikuara nëpërmjet bashkisë (Ndryshimi vjetor në numër)	236	-536		506	Rritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Shpenzimet e programit (mijë lekë)	mijë lekë	7310	7504	8101	8101
Numri i certifikatave të pronësisë të regjistruara	numër	536	0	0	0
Numri i rasteve të gjetura/ inspektuara të tregimit të produkteve bujqësore dhe blektorale në vende dhe tregje informale	numër	3	3	3	5
Sipërfaqja e tokës bujqësore (Ha)	ha	24063	24063	24063	24062,5
Konsultimi publik, keshillimi me fermeret e territorit të Bashkisë	numër			130	

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Dhenie toke me qera (ha)	ha			125	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia ka rritur mbështetjen e fermerëve në skemat kombëtare të aplikimit për grante në fushën e bujqësisë dhe blektorisë, ku 95% të aplikimeve janë fitues (mbështetur). Në sajë të bashkëpunimit të shkëlqyer grante janë marrë nga fermerët nga GIZ dhe donatorë të tjerë.

Duke ngritur grupe pune si në bashki qendër dhe në njësitë administrative . bashkia ka shkurtuar kohën dhe jep ndihmën në kohë reale në shërbim të fermerëve të saj . Duke pasur një sipërfaqe per 24063 ha tokë dhe duke dhëne rreth 125 ha me qera dhe duke bërë rreth 130 konsultime publike tregon se vullneti dhe dëshira për tu marrë me aktivitet në bujqësi dhe blektori të rritet. Me mbështetjen dhe të qeverisë qendrore dhe donatorëve të jashtëm fermerët potencialë kanë mundur të rritin eficiencën dhe cilësinë e produkteve të tyre.

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	20 225	21 162	22 406	22 842	98%
Të tjera korrente	20 322	22 527	35 397	35 397	100%
Kapitale	-	7 840	28 913	28 913	100%
Total	40 547	51 529	86 716	87 152	99%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trend
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Raporti në përqindje i kanaleve ujitëse dhe kulluese në pronësi të bashkisë të pastruara kundrejt rrjetit ujitës dhe kullues në pronësi të bashkisë në total			18		
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Volumi i dherave të lëvizur (në m3)	NA	NA	162455	NA	

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Rezervuarë të mirëmbajtura kundrejt numrit total të rezervuarëve në %			100	100	Rritës
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar)	80	620	3003	3003	Rritës
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Numri i familjeve përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit, ndryshimi vjetor në numër	50	2000	3427	3427	Rritës
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar)	130	2200	11363	11363	Rritës
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)			39		
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)			5		
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të kultivuar ndaj sipërfaqes totale bujqësore	76	76	124	79	Rritës
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Shpenzime për pastrim dhe mirëmbajtje të rrjetit ujitës dhe kullues, kundrejt totalit të rrjetit të pastruar dhe mirëmbajtur (mijë lekë/km)			405		

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total (Km linear)	km	935	935	583	935
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (Ha)	ha	5280	5900	8903	8903,125
Kanale kullues të rikonstruktuar	km	610	754	755	869,55
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total (Km linear)	km	82	82	82	82,1
Shpenzime të programit (mijë lekë)	mije lekë	40547	51529	62099	78367
Inspektime në sistemin ujitës	numër			6	6
Rezervuarë funksionale	numër			6	6
Rezervuar të mirëmbajtur	numër			6	6
Shpenzime për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues (mijë lekë)	mije lekë			49382	54243
Shpenzimet për investime të programit ujitje kullimi	mije lekë	0	7840	12717	24124
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (Ha)	ha	10500	12700	24063	24062,5
Sipërfaqe e tokës bujqësore e kultivuar (Ha)	ha	18245	18310	29881	19009,375
Kanale ujitëse të rikonstruktura (Km linear)	km	143	167	31	163,6
Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	numër	8650	10650	14077	14077
Inspektime në sistemin kullues	numër			12	12
Të ardhura nga tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit (mijë lekë)	mije lekë			1905	11200
Diga të mirëmbajtura	numër			4	
Inspektime në diga	numër			4	
Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	km			32	
Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km	km			32	
Numri i stafit të programit	numër			45	
Volumi i dherave të lëvizura (M3)	m3			162455	
Kanale ujitëse dhe kulluese të pastruara/mirëmbajtura (Km linear)	km			122	

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Rrjet ujitës dhe kullues në pronësi të bashkisë në total (Km linear)	km			665	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes kullimit në bashkinë maliq ka një realizim prej 99% për vitin 2022, ku futen pastrimi i kanaleve kulluese me mjetet e bashkisë, dhe përmirësimi i infrastrukturës për ujitjen e sipërfaqeve tokë për fermerët, shpenzimet për të realizuar këtë janë në vlerën 62099 mijë lek nga të cilat 49382 mijë lek janë shpenzime për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues dhe 12717 mijë lek janë shpenzime për investime të programit ujitje kullimi. Për të mundësuar ujitjen e tokave bujqësore bashkia ka vënë në dispozicion 6 rezervuare me ujë, bashkia disponon rreth 583 km linear rrjet kullues dhe për vitin 2022 janë rikonstruktuar 755 km ndërsa për sa i përket rrjetit ujitës në total janë rreth 82 km linear nga të cilat sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me rrjet ujitës është 8903 ha. Bashkia mirëmban dhe pastron 32 km rrjet ujitës dhe 32 km rrjet kullues dhe ka rikonstruktuar 31 km linear kanale ujitëse për këtë vit. Bashkia ka në pronësi të saj dhe 4 diga të cilat i mirëmban.

Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Administrimi i fondit pyjor dhe kullor

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	12 931	13 361	14 005	14 009	100%
Të tjera korrente	706	1 114	928	928	100%
Kapitale	-	-	-	-	
Total	13 637	14 475	14 933	14 937	100%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Administrimi i fondit pyjor dhe kullor	Sipërfaqe pyjore dhe kullorore me plan menaxhimi ndaj totalit të sipërfaqes pyjore e kullorore (në %)			21		

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Plan menaxhimi (numri i pemëve të shtuara në vit sipas nevojës) ndryshimi vjetor në numër			3000	3000	Rritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Raporti në % i sipërfaqes së dhënë me qira, kundrejt sipërfaqes totale të fondit			1		
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Numër inspektimesh për punonjës	50	94	28	28	Zbritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Mije Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)	0	0		0	
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Raporti i punonjesve të trajnuar kundrejt numrit total të punonjesve të programit (në %)			100	100	Rritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Verifiko nëse ka plan menaxhimi për fondin pyjor dhe / ose kullosor	0	0	7	1	Rritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Numri i pemëve/fidanëve të shtuar në vit	120000	2000	5000	5000	Rritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota	22,5	22,5	23,1	22,5	Rritës
Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor	Numri i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota	0	0	1	1	Rritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Kontrolle dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosor	numër	750	750	750	750
Numri i pemëve të reja të mbjellura në fondin pyjor në vit	numër	120000	2000	5000	5000
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (Ha)	ha	33300	33300	32536	33300
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plane mbarështimi në ha	numër	32362	32362	32536	32362
Numri i punonjesve të administrimit të pyjeve të trajnuar	numër			27	27
Numri i punonjësve për menaxhimin pyje-kullota	numër	15	8	27	27
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (Ha)	ha	22000	22000	25847	22000
Aktivitetet sensibilizuese për mbrojtjen dhe rëndesinë e pyjeve	numër			7	21
Shpenzime për menaxhimin e fondit pyjor (mijë lekë)	mijë lekë	13637	14475		14554
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (Ha)	ha	11300	11300	6649	11300
Plan menaxhimi	numër	0	0	7	1
Shpenzime për investime në pyje dhe kullota (mijë lekë)	mijë lekë	400	0	-	0
Sipërfaqe kullotë e rehabilituar	ha			-	
Kullota të pastruara (Ha)	ha			-	
Lera në total	numër			-	
Ngastra të identifikuar për pastrim dhe nxjerrjen e materialeve drusore	numër			-	
Numri i certifikatave të lëshuara	numër			-	
Projekte të hartuara për pastrim dhe nxjerrjen e materialit drusor	numër			-	
Sipërfaqe kullosore e dhënë me qira (Ha)	ha			-	

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Sipërfaqe prove për ngastër (Ha)	ha			-	
Sipërfaqe pyjore e dhënë me qira (Ha)	ha			-	
Sipërfaqe pyjore në të cilën është shtuar pyllëzimi (Ha)	ha			-	
Sipërfaqe pyjore dhe kullosore e dhënë me qira (Ha)	ha			178	
Sipërfaqe pyjore dhe kullosore e inventarizuar, hipotekuar (Ha)	ha			-	
Të ardhura nga qiratë e pyjeve dhe kullotave (mijë lekë)	mije lekë			7975	
Të ardhura nga tarifa për pyjet dhe kullotat (mijë lekë)	mije lekë			2100	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosur në Maliq ka një realizim prej 100%. Janë bërë rreth 750 kontrole dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosur për një sipërfaqe prej 32.536 ha pyje dhe kullota, nga të cilat janë 25.847 ha fond pyjor dhe 6.649 ha fond kullosor, nga të cilat janë dhënë me qera 17.8 ha. Të ardhurat nga dhënia me qera e pyjeve dhe kullotave janë në vlerën 7.975.000 mijë lek. Të ardhurat nga tarifat për pyje dhe kullota janë në vlerën 2.100.000 mijë lek. Stafi për menaxhimin e fondit të pyjeve dhe kullotave përbëhet nga 27 persona të trajnuar . Numri i pemëve të mbjella në fondin pyjor për vitin 2022 janë 5000 pemë të mbjella në këto teritore. Janë hartuar 7 plane menaxhimi për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor të bashkisë maliq për vitin 2022.

Rrjeti rrugor rural

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	8 519	9 358	9 257	10 102	92%
Të tjera korrente	1 813	3 326	2 824	1 970	143%
Kapitale	47 148	50 779	56 653	90 347	63%
Total	57 480	63 463	68 734	102 419	67%

Projektet Kryesore të Investimeve

Emërtimi i Projektit	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Sist-Asfaltim rruge+sheshe qyteti maliq			7995	13000
Sist-Asfaltim rruge ne Njesite Administrative			0	10000
Sist-Asfaltim rruga Vlocisht Drithas			1596	1596
Rehabilitim rruga Gore-Moglice-betonim	0	0	4180	4180
Mbushje gropash ne rruge	0	0	2000	2000

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Tre
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Raporti në % i rrugëve rurale të mirëmbajtura kundrejt rrjetit rrugor rural në total	100	100	80	100	Zbri
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Numri i makinerive të blera në vit	NA	NA	1	NA	Zbri
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Raporti në % i rrjetit rrugor të mirëmbajtur ndaj rrjetit rrugor total	100	100	75	100	Zbri
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Km rrugë të reja/rikonstruara	2	39	4	2	Rrit
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Km rrugë urbane të mirëmbajtura ndryshimi vjetor në km	0	0	0	0	Sta
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë rurale	92	111	101	161	Zbri
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë urbane	545	107	1098	1160	Rrit
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Rrjeti rrugor urban (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0	Sta
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Rrjeti rrugor rural (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0	Sta
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km)	0	0	0	0	Sta
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Raporti në % i rrjetit rrugor të shtruar (asfaltuar ose me çakull) ndaj rrjetit rrugor total të bashkisë	0	7	1	0	Zbri
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale	Buxheti i shpenzuar për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në km (mije lekë për 1 km rrugë)	100	111	120	179	Rrit

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rural	mije lekë	51480	62245	56653	90347
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	numër	62674	62328	62328	62328
Gjatësia në km e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në vit	km	573	573	430	573
Rrjeti rrugor në Km linear në total (rural / urban)	km	572,9	573	573	572,9
Rrugë rurale të mirëmbajtura	km	562	562	450	562
Gjatësia e rrjetit rrugor rural nën administrimin e bashkisë (Km linear)	km linear	562	562	562	562
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit urban	mije lekë	6000	1218	12081	12762
Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (Km linear)	km	11	11,4	11	11

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Gjatësia e rrjetit rrugor urban nën administrimin e bashkisë (Km linear)	km linear	11	11,4	11	11
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor (mijë lekë)	mijë lekë	57480	63463	68734	102419
Gjatësia në km e rrjetit rrugor të shtruar (asfaltuar ose me çakull) në vit	km	1,6	39,15	4	1,74
Gjatësia totale e rrjetit rrugor të asfaltuar nën administrimin e bashkisë	km	1,6	39,15	179	1,74
Makina të blera	numër			1	
Numri i stafit të programit	numër			23	
Ura në total	numër			29	
Ura të mirëmbajtura	numër			1	
Rrjet rrugor urban i pajisur me sinjalistikë rrugore (Km)	km			11	
Rrjet rrugor urban i ndriçuar në Km	km			11	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Për vitin 2022 Bashkia Maliq duke marrë parasysh shtrirjen dhe popullsinë e saj shpenzimet për menaxhimin e rrjetit rrugor rural shkojnë në vlerën 56653 mijë lek, ndërsa për rrjetin rrugor urban është në vlerën 12081 mijë lek. duke futur këtu shpenzimet për stafin e këtij programi prej 23 personash . mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve , pastrimin e kanaleve anësore të tyre dhe pastrimin e inerteve dhe deboret gjatë periudhës dimërore .Për vitin 2022 janë shtruar me asfalt 4.3 km. Prioritet kanë qenë shtrimin e rrugëve të brendshme të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të maliqit. Rrjeti rrugor urban është rreth 100% i pajisur me sinjalistikën dhe me ndricim rrugor. Po punohet që dhe rrjeti rrugor rural të pajiset me ndricimin e duhur dhe sinjalistikën perkatese. Bashkia ka në administrim 29 ura në total të gjitha funksionale dhe të rregullta, të cilat mirëmbahen dhe janë në funksion të plote.

Menaxhimi i mbetjeve

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Mbetjet urbane



Ndërgjegjësimi mjedisor



Mbrojtja e mjedisit

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Trendi
Mbetjet urbane	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet (ndryshimi i frekuencës në ditë në javë)	0	0	4	4	Rritës
Mbetjet urbane	Totali i të ardhurave nga tarifat e pastrimit kundrejt totalit të mbetjeve urbane (në ton) të menaxhuara nga bashkia (në Mije Lekë / Ton)			4		
Mbetjet urbane	Sasia e mbetjeve urbane e menaxhuar kundrejt numrit total të banorëve që përfitojnë shërbim (ton për frymë)			0		
Mbetjet urbane	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen rurale kundrejt totalit të popullatës rurale (në %)	63	63	634	63	Rritës
Mbetjet urbane	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (ndryshimi i frekuencës në ditë në vit)	0	0	0	0	Stabël
Mbetjet urbane	Raporti në % i popullsisë së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj popullsisë totale të bashkisë	93	93	93	100	Stabël
Mbetjet urbane	Raporti në % i shumës totale të faturuar për shërbimin kundrejt shumës së arkëtuar nga klientët	108	100		49	Rritës
Mbetjet urbane	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim ne zonen urbane kundrejt totalit të popullatës urbane (në %)	56	56	56	56	Rritës
Mbetjet urbane	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	93	53		186	Rritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022
Popullsia në Qytet	numër	7713	7713	7683	7713
Frekuenca e grumbullimit dhe e transportimit të mbetjeve në zonat rurale (ditë në javë)	ditë në javë	7	7	3	7
Frekuenca e grumbullimit dhe e transportimit të mbetjeve në zonat urbane (ditë në javë)	ditë në javë	3	3	7	7
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA ditë ne javë)	ditë në javë	7	7	7	7
Sipërfaqja totale e bashkisë (Km2)	km2	678,51	678,51	656	678,51
Popullësia e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	62674	62328	58152	62328
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	numër	62674	62328	62328	62328
Popullsia në Njësitë administrative	numër	54961	54615	5433	54615
Të ardhurat nga tarifa e shërbimit të mbetjeve (mijë lekë)	mije lekë	20025	21777	24104	44698
Popullësia e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në qytet	numër	4290	4290	4290	4290
Popullësia e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në njësitë administrative	numër	34636	34636	34436	34636
Buxheti për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve (mijë lekë)	mije lekë	21571	40790		24000
Shuma totale e faturuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	mije lekë	21600	21777		21950
